



Kolegji ISPE / Rruga "Enver Maloku" Nr. 49, / info@kolegji-ispe.org / 10 000 Prishtinë / Kosovë

KOLEGJI ISPE

Në bazë të Nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 90/2010), Nenit 35 të Statutit të Kolegji ISPE, Kolegji ISPE shpallë Konkurs për vende të lira të punës:

Prishtinë, 06 Dhjetor 2023

K O N K U R S PËR VENDE TË LIRA TË PUNËS

PËR LËNDËT E PËRGJITHSHME

Nr.	Niveli	Pozita	Vend i lirë	Numri i pozitave
1	SHMLP	Mësimdhënës/e për Gjuhë angleze	Vend i lirë	1
2	SHMLP	Mësimdhënës/e për Gjuhë gjermane	Vend i lirë	1
3	SHMLP	Mësimdhënës/e për Biologji	Vend i lirë	1

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Lëndët e Përgjithshme:

- Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katër vjeçar;
 - Bachelor (katër vjeçar 240 ECTS).

PËR KUALIFIKIMET DHE MODULET PROFESIONALE

Nr.	Niveli	Pozita	Vend i lirë	Numri i pozitave
1	SHMLP	Mësimdhënës/e për Kualifikimin: Teknik i Farmacisë	Vend i lirë	1

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Kualifikimet dhe Modulet Profesionale

Për Kualifikimin: Teknik i Farmacisë:

- Mr.Ph;
- Farmacistë i diplomuar.

KUSHTET DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional si dhe fushën e Arsimit Parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimet Administrative përkatëse të MASHTI-it (UA Nr. 05/2015 dhe UA Nr. 05/2021) si dhe procedurave të përcaktuara me Rregulloret e Brendshme të Kolegjit ISPE.

DOKUMENTET E KËRKUARA

1. CV-ja e kandidatit;
2. Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
3. Diploma (ose Certifikatat), *certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit, nuk do të merret parasysh;*
4. Certifikata që nuk jeni nën hetime.
5. Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

➤ **Kandidatët të cilët ftohen për testin me shkrim, janë ata të cilët i kanë dorëzuar dokumentet e kërkuara sipas këtij Konkursi dhe të cilët i plotësojnë kriteret sipas UA MASHTI (Nr. 05/2015 dhe Nr. 05/2021).**

➤ **Pas plotësimit të kriterëve të konkursit, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheqë 100 pikë apo deri në 50% të vlerësimit përfundimtar.**

➤ **Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohet intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri 100 pikë apo 50% e vlerësimit përfundimtar.**

Vlerësimi në intervistimin me gojë, bazohet në këto kritere:

- Njohuritë e Përgjithshme 25 pikë;
- Aftësitë e përgjithshme dhe Personalitetit 35 pikë dhe
- Njohuritë profesionale 40 pikë (ku përfshihen përvoja e punës dhe kualifikimi profesional gjatë studimeve).

Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, mblidhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjidhen në pozitat e lartcekura.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të Nostrifikuara diplomat nga MASHTI.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

AFATI DHE MËNYRA E APLIKIMIT

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, nga dita e shpalljes së konkursit 06.12.2023 deri më datë 21.12.2023.

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet në Kolegjin ISPE në Adresën: Rr. "Enver Maloku, Nr. 49, Bregu i Diellit, Prishtinë, apo në e-mail adresen zyrtare të Kolegjit ISPE info@kolegji-ispe.org

Për informata të mëtejshme kontaktoni në:

+383 (0) 44 674 566

+383 (0) 45 700 744

www.kolegji-ispe.org

